

GJOVALIN SHKURTAJ

DISA VËREJTJE RRETH GJUHËS SË NAIM FRASHËRIT

Veprat e Naim Frashërit, prej kohësh, janë berë objekt studimi jo vetëm nga kritikët letrarë e historianët e letërsisë, të cilët janë tërhequr nga idetë e mëdha patriotike të dhëna nëpërmjet figurash të bukura artistike, po edhe nga gjuhëtarët, të cilët kanë gjetur aty shfaqje të shumta që flasin për përpjekjet serioze që ka bërë poeti ynë për pasurimin e fjalorit të gjuhës shqipe¹, për vendosjen e një drejtshkrimi të përshtatshëm², për gjallërimin e frazeologjisë popullore duke e futur edhe në veprat poetike³ etj.

Edhe ne, në këtë artikull do të ndalemi në disa dukuri të gjuhës së Naimit të cilat dëshmojnë për kontributin e tij të madh si luftëtar për një drejtshkrim të njësuar, për një normë morfologjike të përpunuar dhe për një pastrim e pasurim të dukshëm të fjalorit të shqipes.

Materialin e kemi nxjerrë nga vështrimi i veprave poetike: «Bagëti e Bujqësia», «Historia e Skënderbeut», «Lulet e Verës», «Parajsa dhe fjala fluturake»⁴ si dhe librat e shkruar në prozë: «Mësimet», «E këndimit çunave këndonjëtorja», «Dituritë për mësonjëtorët e para», «Istori e përgjithëshme»⁵.

I. Drejtshkrimi në veprat e Naimit

Tashmë është një gjë krejt e njohur se parimi themelor i drejtshkrimit të gjuhës shqipe është parimi fonetik. Ky parim, i plotësuar në disa raste edhe nga parimi morfologjik, ka për bazë dhe shpie më tej traditën e shkrimit të gjuhës sonë, e cila, siç dihet, u shestua nga rilindasit tanë të mëdhenj në mes të cilëve zë një vend të rëndësishëm Naimi. Këtu po ndalemi në disa anë të rëndësishme të drejtshkrimit në veprat e Naimit që dëshmojnë se ai vështronte si më të përshtatshëm pikërisht parimin fonetik. Të tilla anë janë:

1. Pasqyrimi, në shkrim, i shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme, në pozicion fundor: m'i math (Il. 4, P. 4), pa funt (Il. 7), një qint (Il. 7), vënt (Il. 7), u tremp (Il. 15), derth (Il. 15), iu përgjiq (Il. 23), s'i erth mirë (Il. 33), me gas (Il. 40), djek (P. 9), të liq (P. 12), rop s'u bë (P. 15), komp (P. 19), ju hoth (P. 23), rrjeth (P. 58), s'm'u ndoth (P. 61), lint (LV. 7), mëngjes (LV. 28), zok (M. 42), dreth (M. 71) etj.

1) N. Jokl, *Naim Be Frashëri e pasurimi i gjuhës shqipe*, në librin *Naim Frashërit nga një grup studentësh*. Graz.

2) A. Xhuvani, *Naimi si poet dhe prozator*, në «Literatura jonë» 3.4.1947.

3) N. Bulka, *Frazeologjia shqipe (lokucionet) në veprën e Naim Frashërit «Historia e Skënderbeut»*, BUSHT, seria ShSh. 1, 1957.

4) Në veprat poetike është inkuadruar edhe përkthimi i «Iliadës» së Homerit.

5) Gjatë mbarështimit, pas fakteve e shembujve që do të citohen, këto vepra do t'i japim me shkurtimet: BB. = Bagëti e Bujqësia; HS. = Historia e Skënderbeut; LV. = Lulet e Verës; IL. = Iliada; M = Mësimet; KÇ. = E këndimit çunave Këndonjëtorja.

Në gjuhën letrare bashkëkohore shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozicion fundor është një veçori shqiptimore e gjallë, mirëpo në të shkruar ruhet trajta e rregulltë me koresponduesit e zëshëm, pra: *i madh, fund, vend, u tremb* etj.

2. Sonorizimi i bashkëtingëlloreve të shurdhëta, të ndodhura pranë bashkëtingëlloreve të zëshme të tilla si *b, d, g, gj*.

Në veprat e Naimit, jo rrallë është shkruar: *zbukuruarë* (K. 3), *z'durojmë* (K. 54), *z'grisej* (K. 30) etj. po nuk mungojnë edhe trajtat me *s*.

3. Trajtat e vetës së tretë njëjës të aoristit të foljeve me zanore të tipit: *punoj, shkoj*. Naimi, në puqje me shqiptimin popullor i shkruante me *j* dhe jo me *i* siç i shkruajmë sot: *Isiodhi s'e fitoj dot.* (Il. 3), *e dërgoj* (Il. 4), *i shpëtoj soje* (Il.5), (Il. 10), *dëgjoj fjalën* (Il. 15), *shikoj kallhënë* (Il. 19), *s'i haroj* (Il. 43), *kur mbaroj lufta* (Il. 55), *kush e bashkoj Italinë* (P. 24), *ku fluturoj bukurija* (LV 32), *pengoj* (M. 33), *lartësoj* (M. 77) etj. Në kohën e Naimit, kur, siç do ta cekim më poshtë, për vetën e parë njëjës të kohës së tashme, për këto folje përdorshin trajtat me *-nj*: *bënj, punonj* etj. nuk kishte rast për homonimi trajtash midis vetës I njëjës të së tashmes dhe vetës III njëjës të aoristit, mirëpo, me kohë *nj-ja* e trajtave të së tashmes u zhvillua në *-j*, kështuqë, po t'i mbaheshim grafisë së Naimit do të krijoheshin trajta homonime. Sot, trajtat e vetës së tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë, nuk shkruhen me *-j*, siç na dalin tek Naimi, por me *i*, pra: *fitoi, shpëtoi, shkroi, dëgjoi, shikoi, harroi, mbaroi, bashkoi, fluturoi* etj.

4. Në emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me *i* të theksuar, në trajtën e shquar, Naimi shkruante edhe një *-j-* midis zanores së temës dhe nyjës shquese: *gjithësija* (Il. 3), *fuqija* (Il. 6), *myslimanërija* (Il. 11.), *selvija* (Il. 58), *mirësija* (P. 9), *Shqipërija* (P. 9), *bagëtija* (P. 11), *mizërija* (P. 11), *varfërija* (P. 12), *miqësija* (P. 12), *Maqedhonija* (P. 12), *Thesprotija* (P. 31), *Mollosija* (P. 31), *bukurija* (LV. 7), *paudhësija* (LV. 11), *djallëzija* (LV 12) etj. Këtë mënyrë shkrimi e kanë përdorur shumë pasardhës të Naimit, nga Jugu e nga Veriu, mirëpo projekti i Rregullave të drejtshkrimit (f. 39 C. I § 4.2) parasheh që të gjithë emrat femërorë, të cilët në trajtën e pashquar mbarojnë me *i* të theksuar, në të shquarën të shkruhen pa *j*, pra: *gjithësia, fuqia, selvia* etj.

5. Pjesëzën *u* të foljeve në trajtën pësore a vetëvetore, Naimi, të shumtën e herës e shkruante bashkë me foljen: *urrit* (Il. 4), *ubë* (Il. 4), *upërhap* (Il. 4) *upërhapnë* (Il. 42), *ubënë rop* (P. 18).

6. Foljet me temë në zanore, në vetën e parë njëjës të kohës së tashme, Naimi i shkruante me mbaresën *-nj*: *nuk e lëshonj* (Il. 13), *mejtonj unë* (Il. 46), *këthenj sytë* (LV, 4), *kujtonj* (LV. 25), *lëndonj* (LV. 25) etj. Trajtat me *-nj* Naimi i përdorte edhe për kohën e pakryer të dëftores: *rrihnje* (P. 14), *shihnje* (P. 14), *pushonja* (LV. 44), *këndonja* (LV. 44); për të tashmen e lidhore: *të besonjë* (P. 32), *të kuptonjë* (P. 32), *mos na mbanjë* (P. 32), *të shpërnderonjë* (P. 4), *dotë na ndritonjë* (P. 55), *të peshonjë* (M. 31), *të gjykonjë* (M. 31), *të përdëllenjë* (M. 45) etj.

Naimi shkruante me *nj* edhe trajtat e disa emrave e mbiemrave si: *lëmenjtë* (P. 9), *ftonjtë* (P. 9), *të mbëdhenj* (Il. 54), *zonjë* (P. 55).

Nga të gjitha rastet që përmendëm, gjuha letrare e shkruar e ka ruajtur *nj-në* vetëm në trajtat e emrave femërore të tipit: *zonjë* dhe në trajtat e shumësit të mashkullorëve të tipit *ftonj, limonj*. Rastet e tjera që përmendëm më sipër, sot, shkruhen me *j* dhe jo me *-nj*, po tradita e Naimit ka vazhduar të ruhet deri vonë tek mjaft autorë jugorë.

7. Në veprat e Naimit, si në poezi ashtu edhe në prozë, është rregull

i gjithmbarshëm elidimi i zanores fundore të patheksuar të ndjekur nga një fjalë që fillon me zanore: *Omiri quhet' at' i vjershësë* (Il. 3), *m'e bukur 'e gjithë Perëndive* (Il. 4), *i ra dh'e shpu* (Il. 5), *Dh'Aqileht'i zotëruar* (Il. 13), *Edh'e mbant'e nuk e linte* (P. 8), *s'm'u ndoth* (P. 61), *më nj'an'i kish* (P. 66) etj.

Një përdorim i tillë i apostrofit, megjithëse ndonjëherë, sidomos në poezi, Naimit i është imponuar edhe nga nevojat e metrit, prapëseprapë mbetet si një shfaqje e teprimit të eufonizmit nga ana e autorit. Pasardhësit e Naimit, gjithnjë e më tepër kanë ardhur duke u rreshtur nga elidimi i zanoreve të patheksuara me qëllim që të ruhet njësia e trajtave në të gjitha përdorimet e tyre. Të shumtën e herës, tek Naimi, apostrofi shpreh ndikimin e madh që kishte poeti nga gjuha e folur, ku, siç dihet, elidimet e tingujve janë mjaft të dendur, po, në disa raste elidimi ka të bëjë me konsiderata etimologjizuese të vetë Naimit. Kështu p.sh. ai shkruan shpesh: *dëshirënë t'ime* (Il. 40), *t'im bir* (Il. 43), *t'anë* (P. 16), *jetësë s'anë* (D. 7) etj. ku apostrofi është një tregues i prejardhjes së trajtave nga shkrirja e nyjes së përparme me rrënjën e pronorit.

Për t'u theksuar është se Naimi, në trajtat e shkurtëra të kontraktuara *ma, ta* nuk e ka përdorur asnjëherë apostrofin, por i ka shkruar gjithnjë sëbashku, ashtu siç shkruhen edhe sot. Në të rrallë, Naimi ka përdorur edhe trajtat dialektore me elidim: *pse t'e mendojmë* (LV. 15), *t'e mundim mallë* (LV. 26) etj.

8. Naimi, me gjithë përpjekjet e dukshme për të shkruar një gjuhë të pastër e të pasur, të kuptueshme për mbarë shqiptarët, nuk shkëputej dot nga disa trajta fonetike të nëndialektit të tij⁶. Kështu p.sh. bie në sy denduria e ç-së në vend të sh-së, si në pozicion nistor ashtu edhe në pozicione të tjera: *çpejt* (Il. 20), *pa çquar* (Il. 24), *çpërblime* (Il. 35), *duke çkarkuar* (P. 67), *çfaqe* (LV 17), *çpuar* (LV 21), *çkëmbejnë* (LV 33), *të mos pyeç* (Il. 46), *t'i març* (Il. 46), *kur të veç* (P. 73), *të hapç* (P. 43) etj.

9. Një nga pikat ku drejtshkrimi i Naimit nuk i është përmbajtur parimit fonetik është shkrimi i ë-së fundore në fjalët proparoksite, në të cilat, siç na dëshmon Samiu në «Shkronjëtoreset e gjuhës shqip»⁷ edhe aso kohe ë-ja nuk shqiptohej: *dihenë* (Il. 3), *besoninë* (Il. 3), *thuhetë* (Il. 3), *Aqilehtinë* (Il. 4), *Afërditësë* (Il. 5), *quheshinë* (Il. 6), *laheshinë* (Il. 7), *janë qytetëruarë* (Il. 10), *përgjigjetë* (Il. 51), *vdekjenë* (P. 12), *trëndafiltë* (P. 46), *tradhëtorëtë* (LV. 47), *mundohenë* (LV. 48), *armikëtë* (LV 48) etj.

Tek Naimi, megjithëse nuk përjashtohen edhe rastet e lëkundjeve e shmangjeve, ka një farë rregullsie mjaft të stabilizuar për përdorimin e ë-së fundore. Kështu p.sh. na del se ai nuk e shkruante ë-në fundore në këto raste:

a) Në emrat e rasës vendore: *n'ushtërit të Priamit* (Il. 7), *në Iliadhët* (Il. 7), *në mëmëdhet* (Il. 8), *në skëterrët* (Il. 8), *më anët tjetërë* (Il. 35), *në ushtresët* (Il. 42), *me ndihmët* (Il. 51), *në gjithë botët* (P. 3), *në Shqipërit* (P. 9), *në diturit* (P. 23), *nën strehët* (LV. 4), *n'anët* (LV. 30), *n'errësirët* (LV. 45) etj.

6) Khs. trajtat: u çfaq, çkarkoj, çpejt etj. që ka e folmja e Dangëllisë, sipas S. Floqit *Skicë e të folmes së Dangëllisë*, BUSHT, SSHSH, 3, 1958, f. 93.

7) «Kështu shkruajmë: *punë, verë, erdhi, emërë, paskeshinë*. Po gjuha e do aqë fort të xgjaturitë në rrokjet që është para së fundit sa në të folurë i presim më shumë të zëshmetë ë që vine pas asaj. Kështu në vendit të: *hequrë, thoshinë, motërë, punënë*, themi: *hequr, thoshin, motër a motër, punën* etj.» (S. Frashëri, *Shkronjëtoreset e gjuhës shqip* 1886, f. 4.)

b) Në rasën gjindore ose dhanore të shquar në numrin shumë: *nga gjithë fëlliqjet'e ligësivet* (M. 29), *e gjithë të miravet* (M. 43), *të motravet* (M. 45), edhe *pasësvet* (M. 29), *e mëmëdhetarëvet* (M. 54), *gjithë qiejvet* (M. 51), *fytyravet* (M. 76). Në gjuhën letrare shqipe, ë-ja fundore në fjalët proparoksitone është reduktuar në shkallën zero dhe sot, fjalët proparoksitone që Naimi i shkruante me ë në fund, ne i shkruajmë gjithnjë pa ë: *besonin, dihen, thuhet, Afërditës, quheshin, përgjigjet* etj.

Theksi i fjalës

Dihet se në gjuhën e sotme shqipe, në asnjë nga stilet e saj të shkruar, nuk vihet theksi i fjalës. Kjo ngjet për arsye se në gjuhën tonë, edhe në raste të tilla si *bári — bari, drejtóri — drejtori* etj., në saje të kontekstit del e qartë se për cilën është fjala, çka mjafton për të bërë diferencimin shqiptimor edhe në mungesë të shenjës së theksit. Po Naimi, si njeri nga lavruesit më të zellshëm të shqipes, i ndërjegjshëm se në veprat e tij, sidomos në shkrimet në prozë, lexuesi shqiptar do të ndeshej me shumë fjalë e terma të reja, të panjohura (kryesisht neologjizma të krijuara prej atij vetë), me emra njerëzish e visesh nga më të ndryshmit, të cilët për herë të parë jepeshin në trajtën e gjuhës shqipe, e ndjente të nevojshme që herëpashere të vinte disa theksa. Kështu p.sh. në veprën «Istori e përgjithëshme» (botim i vitit 1886) Naimi ka vënë shenjën e theksit mbi emra të huaj si: *Evropjánëtë* (f. 6), *Kínasitë* (f. 6), *Tatárëtë* (f. 6), *Pérsëtë* (f. 6), *Turánasë* (f. 6), *sanskrishteja* (f. 6), *Qeltíshtenë* (f. 7), *spanjolishteja* (f. 7), *Himalájetë* (f. 9), *Egjýptetë* (f. 10), *Brahámnë* (f. 10), *Púdenë* (f. 10) etj.

Përveç emrave të huaj, Naimi e quante me vend të theksonte edhe disa fjalë të reja a kalke, krijuar prej atij vetë ose marrë prej të tjerëve si: *balsamósurë* (IP. 13), *shkrónjat'e Egjyptesë* (IP. 13), *shtjésëtë* (IP. 21).

Me shenjën e theksit dalin edhe një varg fjalësh të tjera paroksitone dhe proparoksitone, shumë të përdorshme edhe në të folurit popullor si: *thóshinë* (IP. 11), *besóninë* (IP. 11), *t'ahérs'hime* (IP. 11), *gjenjesë* (IP. 11), *véndinë* (IP. 10), *ujëratë* (IP. 19).

Naimi e ka vënë shenjën e theksit edhe në ca fjalë oksitone si: *edhé* (IP. 11), *sepsé* (IP. 11), *kétó* (IP. 11), *pastáj* (IP. 10), *qytét* (IP. 14) *vëlláj* (IP. 14), *djallëzúj* (IP. 9), *shpëtój* (IP. 19), *bukurí* (BB. 15), *atý* (BB. 15) etj.

Shpesh, Naimi vinte theks edhe në fjalët që kishin në përbërje togjet *ua* dhe *ye*: *të shkrúara* (IP. 10), *e nxúar* (IP. 11), *mundúarë* (IP. 12), *psúanë* (IP. 14), *të tmerúuara* (IP. 18), *duke kthýerë* (IP. 22), *të dëgjúarë* (IP. 25) etj. Në këtë pikë, Naimi na del si një luftëtar për të futur në gjuhën letrare jo çdo gjë nga të folmet popullore, por vetëm ato që ishin më të përgjithshme. Kështu ai, duke vënë shenjën e theksit mbi *u*-në e *y*-në e togjeve *ua*, *ye*, kërkonte që të shmangej nga gjuha letrare diftongu, në të mirë të togut të zanoreve. Këtë nismë të drejtë të Naimit, gjuha letrare e sotme, sadoqë nuk e gjen të nevojshme shënimin e theksit, e ka realizuar krejtësisht dhe diftongut *ua*, edhe pse gjëllin ende në ca të folme të Jugut, nuk i është bërë vend në gjuhën letrare.

Përveç theksit të prehtë (◌) të cilin, sikundër thamë, e gjejmë në fjalët oksitone, paroksitone dhe proparoksitone, Naimi ka përdorur edhe theksin e trashë (◌), funksioni i të cilit nuk del fort i qartë, por, me sa duket, do ta ketë përdorur për të shënuar zgjatjen e zanoreve: *kúrrë, gúrë* etj.

Drejtshkrimi i emrave të përveçëm me prejardhje të huaj.

Kontributi i Naimit ka qenë i shumanshëm. Ai është jo vetëm këngëtar i mallit për atdhe e i trimërisë së zëmadhit Skënderbe, por edhe një edukator i urtë e një përkthyes i aftë. Duke përshtatur «Mësimet», qëllimi i të cilave ishte dhënja e një edukate morale dhe e një dije fillestare për shkencat, si dhe gjatë përkthimit të «Iliadës» së Homerit, Naimit iu desh ta njihnte lexuesin shqiptar me terma, toponime e personazhe, të cilët për herë të parë visheshin me petkun e gjuhës shqipe. Aty, tradita e shkrimit të atyre fjalëve, toponimeve a emrave të personazheve në gjuhët e huaja përkatëse, ndeshej me praktikën e ndjekur nga përkthyesit e ndryshëm në gjuhët e tjera që njihnte Naimi si dhe me dëshirën e tij, për t'i përshtatur ato sa të ishte e mundur e më tepër, sipas natyrës së fonetikës dhe të fleksionit të gjuhës shqipe. Kështu p.sh. tek «Iliadh'e Omirit» dhe në vepra të tjera janë të shpeshë rastet e përshtatjes analogjike të trajtës së emrave të përveçëm si: *Agamemnuua* (Il. 4), *papa Evjenuua* (Il. 4), *Ifestua* (Il. 6), *Likurgua* (Il. 8), *Kolombua* (IP. 76), etj. në analogji me trajtat e njohura popullore të emrave të tipit *Spiro-Spirua*, *Bino-Binua* etj.

Parimi bazë i shkrimit të emrave me prejardhje të huaj për Naimin ishte shkrimi sipas grafisë së tyre në gjuhët nga mirreshin, po kur gjente rasën, sikundër e thamë më lart, Naimi synonte që emrat me prejardhje të huaj t'i bënte sa më të ngjashëm me emrat shqiptarë. Dëshmi për këtë janë raste si *Danti* (Il. 10) për Dante, *Patrarku* (Il. 10) për Petrarka, *Tasi* (Il. 10) për Tasso, *Enisë* (Il. 56) për *Eneut*, *Jane-e-Hargut* (IP. 74) për Zhanë d'Ark etj. (fr. Jeanne d'Arc).

Emrat me prejardhje nga gjuha greke Naimi i shkruante me *th* e *dh* sipas grafisë së greqishtes së re: *Posidhonë* (Il. 6), *Thiseu* (Il. 6), *Evripidhi* (Il. 10), *Eniadhenë* (Il. 10), *t'Odhisjesë* (Il. 8), *Theatrosë* (Il. 11), *Pindhari* (Il. 10), *Sminidhës* (Il. 15), *Vrisiidhën-bukuroshe* (Il. 24), *Mirmidhonet* (Il. 33), *Dhanajinjet* (Il. 40), *qitharën* (Il. 49), *Thivë* (P. 5), *Aleksandhria* (P. 6), *Maqedhonija* (P. 31), *Thodhoriku* (IP. 58), *Promitheu* (IP. 28) etj. Ky drejtshkrim është mbajtur deri në ditët tona nga shumë shkrimtarë tanët, po projekti i Rregullave të drejtshkrimit i vitit 1967 parasheh që emra e fjalë të tilla të shkruhen me *d*, *t* e jo me *dh*, *th*. (f. 55, Ç § 1, 11), duke bërë vetëm pak përjashtime si *Theodhor*, *Theodhora*, *Dhimitër* etj. (f. 56, Ç § 11 shënim].

Fjalët që në greqishten e vjetër fillojnë me zanore të aspiruar dhe në latinishten me *h-*, Naimi zakonisht i shkruante pa *h*: *Omiri* (Il. 3), *Isiodhi* (Il. 3), *Elenën* (Il. 3), *Ifestua* (Il. 6), *Irakliu* (Il. 6), *Ektorit* (Il. 50), *Unjadhë* (Il. 19), *Anibalë* (IP. 52) etj., po nuk mungojnë edhe rastet me *h*, si: *Horasi* (Il. 10) etj. Herë-herë tek Naimi ka edhe lëkundje p.sh. *Ollanda* (IP. 79) dhe *Hollanda* (D. 93) etj. Gjendja, ashtu me lëkundje si në veprat e Naimit ka vazhduar deri vonë, por gjithnjë prirja më e fortë ka qenë për t'i shkruar me *h-*.

Emrat e përveçëm kryesisht me burim grek, latin ose ilirotrak që nisnin me *au*, *eu*, Naimi i shkruante me *av*, *ev* ose *af*, *ef*: *Glafko* (IP. 99), *Zevsi* (IP. 27), *Teftonëvet* (IP. 75), *Evropjanëtë* (IP. 6), *Evropasit* (IP. 6), *Evropa* (D. 92) etj. Nga të gjithë këta, sot shkruhen me *ev* vetëm *Evropa*, *evropian*, ndërsa për të tjerët, projekti i drejtshkrimit parasheh të shkruhen përkatësisht me *au*, *eu*, pra: *Glauko*, *Zeusi*, *Teutonët* etj.

Përdorimi i vizës lidhëse

Naimi shkruante me vizë në mes:

a) Të gjitha fjalët e përbëra: *fjalë-bukurësë* (Il. 6), *gjysmë-njeri* (Il. 6), *pulpë-mirë* (Il. 3), *lesh-bukura* (Il. 15), *hark-ergjentë* (Il. 15), *ëndërrë-rrë-fenjës* (Il. 17), *dritë-dhënës* (Il. 17), *këmbë-çpejtë* (Il. 18), *këmbë-ergjentë* (P. 12) *lesh-florinjë* (P. 10), *mes-hollë* (P. 11), *gjak-ngrirë* (P. 62), *dhëmbje-math* (M. 29) *dorë-hapëti* (M. 40) etj.

b) Të gjitha fjalët e prejardhura të formuara me parashtesën *pa-*: *i pa-anë* (Il. 34), *i pa-besë* (p. 29), *të pa-qenë* (P. 28), *pa-ditja* (P. 33), *pa-gjumë* (P. 34), *pa-fe* (P. 35), *pa-anë* (M. 30), *pa-faj* (M. 30), *pa-ndyrë* (M. 30) etj.

c) Të gjitha formimet e përfutuara nga përsëritja e së njëjtës fjalë, si: *derë-më-derë* (Il. 8), *një-për-një* (Il. 29), *palë-palë* (Il. 41), *brinjë-për-brinjë* (P. 13), *besa-besë* (P. 29), *sot-për-sot* (P. 31), *cazë-nga-cazë* (P. 70), *tej-për-tej* (LV 11).

ç) Fjalët e përngjitura dhe numërorët e përbërë: *një-zet* (Il. 31), *dy-mbë-dhetënë* (Il. 38, P. 13), *do-mos-do* (Il. 47), *tri-dhetë* (Il. 59), *kur-do-herë* (LV. 22); *sicili-do* (LV. 41), *tek-do* (M. 31), *ku-do* (M. 31), *dalë-nga-dalë* (M.54) etj.

d) Trajtat e shkurtëra enklitike të foljeve: *bë-na*, *fal-na*, *mërgo-na* (M. 35), *sill-ma* (M. 37), *fal-ju-ni* (M. 47), *nem-ni* (M. 48), *lut-ju-ni* (M. 48).

e) Shpesh, Naimi ndante me vizë edhe nyjen e përparme nga mbiemrat e nyjshëm: *i-vërtetë* (HS. 3), *i-gjatë* (HS. 11), *i-thatë* (HS. 11), *i-zeshk* (HS. 11), *trim i-vlerë* (HS. 11), *të-tjerë* (HS. 12), *të-vërteta* (HS. 12), *i-vrenjtur* (HS. 15), *i-zemëruar* (HS. 15) *e-urt'e e-xgjuar* (HS. 19) etj.

Në përgjithësi Naimi e ka zbatuar mirë parimin e ndarjes së fjalëve me vizë, çka tregon për punën e ngultë të tij për një reformë të saktë drejtshkrimore, por nuk mungojnë edhe luhatjet e shmangjet, p.sh. për fjalën *përnjëherë* ka dy mënyra shkrimi: *herë me dy viza në mes për-një-herë* (K. 33), *herë krejt ndarazi si tri fjalë të veçanta për një herë* (K. 49).

II. Trajtat morfologjike në veprat e Naimit

Sikundër e kemi thënë edhe më sipër, Naim Frashëri, me veprimtarinë e tij letrare, synonte t'u vinte në ndihmë jo një pakice të mësuarish, po masave të gjëra të popullit, bujqve dhe blegtorëve të thjeshtë. Kjo është arsyeja që gjuha e Naimit, trajtat morfologjike dhe struktura sintaksore e veprave të tij, shpesh, janë krejt të njëjta me ato të gjuhës së folur popullore. Po Naimi, duke qenë njëherazi edhe mjeshtër i fjalës, ka shfrytëzuar shumë liritë poetike dhe nëpërmjet tyre ia ka dalë që poezitë e tij të jenë të thjeshta, të kuptueshme dhe në përshtatje me kërkesat e artit poetik, të cilin ai e ka njohur dhe aplikuar me aftësi.

Trajtat morfologjike më dalluese të veprave të Naimit, në krahasim me gjuhën e sotme letrare janë:

1) Emrat që në njëjës të pashquar mbarojnë me *-e* ose *-je*, të cilët, sikundër dihet, në gjuhën e sotme kur shquhen e bjerrin *e-në*, në veprat e Naimit e ruanin atë: *Pellazgjishtëja*, *Frëngjishtëja*, *Sanskrishtëja*, *Qel-tishtëja*, *Spanjolishtëja* etj. çka rrëfen se Naimi, synonte për ruajtjen e një teme uniforme për të shquarën edhe të pashquarën.

2) *Mbaresa e emrave në rasën gjindore-dhanore-shumës*. Në veprat e Naimit, krahas trajtave me mbaresën *-ve*, të barabarta me të sotmet, si:

gravet (P. 60), *vashavet* (P. 60), *të ravet* (P. 60) etj. në fjalët që e bëjnë shumësin me bashkëtingëllore gjenden dendur edhe trajtat me mbaresën e vjetër -e (t), pa v-në epentetike: në *gjuhët të Hindaset e të Kinaset* (Il. 3), *i të vdekuret* (Il. 6), *Pellazgjinjet* (Il. 7), *e djemet* (Il. 14), *m'i mir'i gjithë shtjeset* (Il. 17), *të njerëzet* (Il. 28), *u ka dhënë dhanajinjet* (Il. 40). Për ruajtjen e mbaresës -e(t) në veprat e veta Naimi është ndikuar nga gjuha popullore dhe trajtat nëndialektore të vendlindjes ku, ato trajta ruhen ende në brezin e vjetër⁸.

Në të folmet popullore, në Jug e në Veri, deri vonë rasa gjindore-dhanore shumë e emrave që mbarojnë me bashkëtingëllore, formohej duke vënë drejtpërsëdrejti mbaresën -e: *pleq-pleqet, miq-miqet* etj. të cilat kanë qenë të gjithmbarshme në veprat e autorëve të vjetër si Budi, Bogdani dhe tek mjaft shkrimtarë të Rilindjes. Të dhënat e dialekteve rrëfejnë se trajta të tilla gjëllin ende, si në të folme të Jugut ashtu edhe në të Veriut.

3) *E ashtuquajtura rasë vendore*. Naimi, ashtu si edhe shumë rilindas të tjerë, pas parafjalëve: *në, ndë, nënë, ndënë, më, mi, mbi, nëpër, për, me*, përdorte trajta të veçanta të formuara me nyjën t, të cilat A. Xhuvani i ka quajtur trajta të lokativit (vendores). Kështu p.sh. lexojmë dendur: *n'ushtrit të Priamit* (Il. 4), *në faltoret* (Il. 7), *në Iliadhët* (Il. 7), *në mëmëdhet* (Il. 8), *në skëterrët* (Il. 8), *në gjithë botët* (P. 3), *në Shqipërit* (P. 9), *në atë kohët* (P. 13), *ish në diturit si deti* (P. 23), *me gjuhët të saj* (P. 32) etj. Edhe këtë trajtë Naimi e mori nga gjuha e folur, duke pasur për bazë kryesisht nëndialektin e fshatit të lindjes, Dangëllisë.

4) *Trajtat e rasës kallëzore*. — Në rasën kallëzore, për emrat e shquar të numrit njëjës, gjinia mashkullore, mbaresa rasore -n(ë) u shtohet drejtpërsëdrejti temave emërore, pa nyjet anaptikse analogjike u ose i: *Ibrahimmë* (P. 22), *trimnë* (P. 22), *veshnë* (P. 31), *Skënderbenë* (P. 34), *rreziknë* (P. 41), *miknë* (P. 41), *zotnë* (P. 46), *shoku-shoknë* (P. 54), *synë* (P. 60), *florinë* (P. 63), *trimn'e mirë* (Il. 53) etj.

5) *Përemrat*. Naimi, megjithëse, sikundër është thënë më sipër, për drejtshkrimin e disa përemrave ka ndjekur parime që sot nuk i ndjekim, siç është p.sh. ndarja me apostrof: *fytyrën t'ënde* (M. 31), *të parët t'anë* (P. 75), *shpirtit t'im* (LV. 25), *gjuhënë t'ënë* (M. 56) etj. përsa u takon trajtave të përemrave, në mjaft raste, mbetet edhe sot për t'u pasur si shembull nga shkrimtarët tanë. Kështu p.sh. ai ka përdorur pa i shpërdoruar rasat e zhdrejta të pronorëvet *urdhëri yt* (M. 51), *të dërguarit tënt* (M. 69), *tyt'eti* (Il. 37), *ndaj meje* (P. 69) etj..

Në veprat e ndryshme të Naimit është përdorur shpesh trajta *syresh*; p.sh. *para syresh* (Il. 71), *përpara syresh* (Il. 43), *shumë syresh* (Il. 14) etj. Kjo trajtë, që është përdorur edhe nga rilindas të tjerë, gjëllin edhe sot.

Një veçori tjetër dalluese e veprave të Naimit është dhe përdorimi i përemrave të rasës rrjedhore pa parafjalë në funksionin e plotësve të ndryshëm, p.sh. *shpëtoj soje* (Il. 51), *dil soje zjar* (Il. 6), *të më shpëtosh soje* (Il. 18), *edhe ata q'e bënë nesh qenë* (P. 24), *bukurija teje buron* (LV. 54), *qiriri meje ka mësuar* (LV. 53), *buron soje miqësija* (LV. 20), *t'u thuash meje të fala* (P. 73) etj.

6) *Trajtat e foljeve*. Në veprat e Naimit trajtat e foljeve janë të lëkundëshme; ato herë afrojnë me trajtat e nëndialektet e herë priren drejt trajtave të përgjithëshme të koinesë jugore.

8) S. Floqi, *art. cit.*, f. 98.

a) Për vetën e parë shumë të foljeve në kohën e tashme, ka edhe shembuj me mbaresat: *im*, *-ni*, *-in*, njësoj si në gjuhën e sotme letrare: *shohim* (P. 55), *njohim* (P. 55, LV. 41), *marrimë* (D. 141), *nxjerrimë* (G. 75), po edhe trajta me mbaresat *-ëm*, *-në*, *-ën*: *shohëm* (IP. 4, LV. 10), *humbasëm* (LV. 34), *shohënë* (M. 44), *marrënë* (M. 44), *vdesënë* (M. 69) etj..

b) Ndërsa për vetën I, II njëjës, përdor trajtat e rregullta të së kryerës me mbaresat *-nja*, *-nje* p.sh. *shkonja* (P. 14), *shihnje* (P. 14), *donja* (P. 69) etj. për vetën e tretë njëjës shumë shpesh përdor trajtat dialektore, pa mbaresë: *dil soje zjar* (Il. 6), *zij radhë të re* (Il. 8), *pij ujët* (Il. 8), *e doj shumë* (Il. 36), *rrij e haj zemrën e tija* (Il. 42), *s'e liq të ikënte* (Il. 53), *as këndoj as haj as pinte* (P. 71) etj. Megjithatë nuk mungojnë edhe rastet me mbaresën *-nte*; si: *i tepëronte* (P. 12), *ikënte* (Il. 16), *mbarontz* (Il. 42) etj.

c) Foljet e trajtës pësore, gjatë zgjedhimit, para mbaresave vetore, herë marrin anaptiksen *h*, sikundër edhe në gjuhën e sotme letrare *do të helmohet* (Il. 27), *bëhetë* (P. 65), *kthehetë* (Il. 44), *mundohenë* (LV. 48), herë anaptiksen *n* në nëndialektet e toskërishtes: *dëgjohet* (LV. 3), *ndritonet* (LV. 3), *bënem* (LV. 22), *të bënet* (Il. 29), *mbaronen*, (P. 53), *trashëgonen* (P. 53) etj.

ç) Në të kryerën e thjeshtë foljet me zanore të tipit *dërgoj*, *shtyj*, në vetën e tretë njëjës, herë dalin me mbaresën *-j* (= *i*) si në gjuhën e sotme: *mësoj* (M. 31), *shënoj zoti* (M. 33), *i lartësoj* (M. 77), *i dërgoj* (Il. 40), *kur mbaroj lufta* (Il. 55), *vërshoj* (Il. 59), *shikoj kallhenë* (Il. 19) etj. herë me mbaresën *-jti*: *lëshojti* (Il. 19), *shikojti* (Il. 22), *dërgojti* (Il. 32), *nderojti* (P. 16), *nuk e ndajti* (P. 21) etj., të cilat s'janë tjetër veçse nëndialektalizma që kanë depërtuar në veprat e Naimit si ndikim i gjuhës së folur.

Në veprat e veta Naimi ka përdorur edhe aoristin sigmatik p.sh. *s'undodhçë* (K. 28), *kur arçë* (K. 31), *mbeçë* (K. 31), *vajçë* (K. 34) etj. të cilat i ka marrë nga e folmja e vendlindjes⁹.

d) *E ardhmja* — Trajta kryesore e së ardhmes në veprat e Naimit është ajo që formohet duke u paravënë pjesëzën *do*, trajtave të së tashmes dhe të së kryerës së lidhores. Me fjalë të tjera në veprat e Naimit gjejmë një trajtë të njëjtë me atë që përdorim edhe sot në gjuhën letrare: *dotë t'ap shumë gjë* (Il. 5), *dot'a them, po epmë fjalën* (Il. 17), *dotë helmohet* (Il. 27), *dotë bindet* (Il. 39), *dot'i kupëtonjë* (P. 25), *e zeza do t'u presë* (P. 29), *dotë më thuash* (P. 63), *dota njohin* (LV. 49) etj. Siç shihet edhe nga këta shembuj që dhamë, ndryshimi në mes të trajtave të së ardhmes tek Naimi dhe atyre të gjuhës letrare të sotme, është vetëm në drejtshkrim: Naimi pjesëzën *do* e shkrinte më një me pjesëzën *të* të lidhores. Në sot i shkruajmë të ndara, mirëpo herë-herë krijohen edhe trajta homonime, të cilat e vështirësojnë evidencimin e së ardhmes (si trajtë e veçantë) nga fjalitë volitive të ndërtuara me foljen *dua* si kallëzues për fjalinë kryesore. P.sh. *do të shkosh?* mund të jetë edhe folje në kohën e ardhme, po edhe një frazë, ku *do* ka kuptimin e mirëfilltë e s'është pjesëz trajtëformuese. Po të shihet çështja me këtë sy, mund të thuhet se drejtshkrimi i trajtave të së ardhmes tek Naimi ka qenë më i përshtatshëm për të mënjtuar dyzime të tilla, të cilat nuk janë të rralla.

dh) *Pjesorja*. Trajta e pjesores, në shumicën e rasteve janë po ato të gjuhës së sotme letrare. Madje, është për t'u vënë re se Naimi ato trajta të pjesores, të cilat sot, në letërsinë artistike, në publicistikë dhe në letërsinë shkencore, nuk përdoren drejt: në veprat e Naimit gjenden gjithnjë

9) S. Floqi, *art. cit.*, f. 104.

me trajtat e duhura. Fjala është për pjesoret e foljeve me bashkëtingëlloret *ll, l, rr* si: *vjel, mjel, mbjell, vjell, nxjerr, marr, dal* etj. Këto folje, përbëjnë një grup që në pjesore nuk marrin mbaresën *-ur*, por thjesht *-ë*. Naimi e ruante gjithnjë këtë rregullsi: *ka pjellë* (Il. 30), *duke pshjellë* (Il. 32), *duke nxjerrë* (Il. 34, LV. 14), *duke dalë* (Il. 43), *mbjellë, pjellë, sjellë* (LV. 15) etj.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për raste të tjera, si p.sh. për pjesoren e foljes *kam*. Naimi ka përdorur gjithnjë trajtën *pasurë*: *s'ka pasurë* (Il. 11, P. 6, LV. 16 etj.)

dh) Trajatat e përcjellores, në veprat e Naimit, herë kanë pjesëzën *duke*, herë *dyke*, p.sh. *duke thënë* (Il. 40), *dyke ngritur* (Il. 40), *dyke mejtuar* (P. 46), *duke fluturuar* (P. 75) etj. Përndryshe ato paraqiten të njëjta me trajtat letrare të sotme.

e) Në veprat e Naimit, si në prozë ashtu edhe në poezi, janë përdorur trajtat e pësores pa pjesëzën *u*: *pa plakur lark mëmëdheut* (Il. 15), në vend të *pa u plakur*; *ata duke turpëruar e duke trembur nga mbreti* (Il. 33), në vend të *duke u turpëruar e duke u trëmbur*; dhe *duke tretur e tharë* (P. 8), në vend të *duke u tretur...*, *duke përzierë* (IP. 9), në vend të *duke u përzierë, duke bërë mik me persët* (IP. 41), në vend të *duke u bërë...* Këtë veçori e gjejmë edhe në veprat e Samiut.¹⁰

7) *Parafjalët*. — Nga parafjalët që gjenden në veprat e Naimit, në krahasim me ato që përdoren edhe sot, paraqesin interes:

ndë, ndë të (M. 30), *nd'ujët* (M. 30), *nd'erët* (M. 30) etj. Shembujt që kemi nxjerrë nga veprat e Naimit, dëshmojnë se *ndë* do të ketë qenë një variant fonetik i parafjalës *në*, e cila përdorej kryesisht me emrat që fillonin me zanore. Relikte të asaj parafjale dialektologët tanë kanë gjetur jo vetëm në të folmet e jugut, p.sh. në zonën e Korçës: *dë hundë*¹¹ po edhe në Veri, p.sh. shprehjen «*u pytsh t'uj!*» të cilën e kemi dëgjuar në Kelmend, ne e barazojmë me «*u mbytsh ndë ujë!*» dhe *t-në* e vështrojmë si një mbeturi të parafjalës *ndë*.

8) Disa gegizma

Në veprat e Naimit gjenden disa trajta foljore perifrastike të cilat, afrojnë me trajtat e gegërishtes. Të tilla janë: *Hyji për me mos prishurë dëfrimnë* (Ul. 5), *me mos dashur t'apë* (Il. 39), *me qenë gjallë Shqipetari, ç'kërkon Greku dhe Bullgari* (P. 29), etj...

Për këto trajta, prof. A. Xhuvani, ka pasur mendimin se ato «*janë gjurma të vjetra të gegënishtes ose t'asaj epoke, kur dy dialektet, gegënishtja e toskënishtja ishin më afër njena me tjetrën...*»¹²

Ky mendim është i drejtë vetëm për ndonjë trajtë, siç është p.sh. e ashtuqajtura mënyrë lidhore-habitore, formë analitiko-sintetike e cila ngërthen në vete veçoritë formale të habitores dhe të lidhores p.sh. Të *qenkeshmë* berë baltë (M. 74) ose: *të paskështa vrapn'* e veriut (HS. —) etj. Një trajtë të tillë ne e kemi gjetur edhe në të folmet e skajit verior, në Malësi të Madhe.

10) Sh. Demiraj, *Disa shënime rreth lëvrimin të gjuhës shqipe gjatë shek XIX*, BUSHT, SSSH, 1, 1959, f. 60.

11) J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*; V. Milkani, *E folmja e Bulgarecit*, dorëshkrim.

12) A. Xhuvani, *Naimi si poet dhe si prozator*, në «*Literatura jonë*», 3-4, 1947 f. 9-10.

Përkundrazi për trajta të tilla si paskajorja me pjesëzën *me: me mos dashur* etj. ne na duket më i pranueshëm vlerësimi që ka dhënë Sh. Demiraj: «Nën nxitjen e idevet të lëvizjes patriotike të Rilindjes, që synonte në radhë të parë bashkimin dhe vëllazërimin e të gjithë shqiptarëve pa dallim feje dhe krahine, disa nga shkrimtarët jugorë të shekullit të kaluar si Samiu, Vretua etj. përdorën në veprat e tyre edhe disa fjalë, trajta fjalësh dhe forma morfologjike nga të gegërishtes». ¹³

III. Naim Frashëri luftëtar për pastërtinë dhe pasurimin e gjuhës shqipe

Atë që kërkonte për të gjithë shqiptarët:

«Shqip të flisni përherë

Fjeshtë të papërzjerë...»

(Parajsa... 45), Naimi

e ka zbatuar më së miri në veprat e veta. Ai, sikundër i vëllai, Samiu dhe shumë rilindas të tjerë, ishte luftëtar për një shqipe të pastër, pa fjalë të huaja, për një shqipe brumi i së cilës të ngjishej e të gatuhej sa më mirë, duke flakur jashtë saj sidomos fjalët e huaja. Këtë e ka shprehur qartë në shënimet që ka dhënë poeti në hyrje të «Iliadës» së Homerit, ku, duke vlerësuar trashigiminë letrare të bejtashinjve, shkruan: «Në mest të vjershëtorëve të Shqipërisë ka zënë kryenë Hasan i Zyko Kamberit; pas ati janë: Nezimi, Hixhretiu etj. Po të gjithë kanë bërë faj që s'faletë, e të metë, që s'ndjehetë kurrë. Kanë përzjerë gjuhën'e bukurë shqip me fjalë të huaja! Gjuha jonë duhet shkruarë fjeshtë shqip, se fjalët e huaja e shëmtojnë shumë. Është e gjerë gjuha jonë dh'e bukurë shumë, ka fjalë fort të mira për të vënë në vënt të fjalëve të huaja» («Iliadha e Omirit», f. 11-12).

Po një gjuhë e shkruar, në të cilën do të shpreheshin ndjesi të holla, të një patrioti-pishtar dhe dituri nga më të ndryshmet për të cilat kishte aq nevojë populli shqiptar, nuk mund të mbahej vetëm me fjalët e të folmeve popullore. Për këtë arsye Naimi, sikundër edhe rilindasit e tjerë, kërkoi dhe gjeti rrugë të reja, deri atëhere të pashkelura, për pasurimin e shqipes, për pajisjen e saj me termat dhe fjalët e nevojshme për të shprehur sa më qartë dituritë, mësimet, dhe ndjenjat e larta të atdhedashurisë. Duke vënë në pah rëndësinë madhore që pati vepra e Naimit në këtë drejtim, albanisti i shquar Norbert Jokl ka thënë: «Historia e gjuhëve të kulturave na mëson prej shumë shembëllash që gjinden perioda, ku pasunimi i fjalorit asht i nevojshëm. Në histori të çdo populli ka disa ndërrime udhësh, që mbas një gjumi shumë të gjatë, zgjohet ai popull përsëri për me gëzue një jetë të re mendore. Kështu edhe punimi i Naim Frashërit bie në një period të tillë të historisë shqiptare». ¹⁴ (në librin «Naim Frashëri» nga një grup studentësh, Graz, 1925). Në hyrje të këtij artikulli, në të cilin ka bërë një analizë mjaft të mirë të mjeteve fjalëformuese që janë përdorur në veprat e Naimit, N. Jokli e ka krahasuar poetin tonë me të tilla figura të shquara për pasurimin e gjuhës amtare si Leibnizi, për gjermanishten, Jozef Jugmani për çekishten dhe Vuk Stefan Karaxhixhi për serbishten.

Dhe vërtet, duke lexuar veprat e Naim Frashërit, jo vetëm syri i

13) Sh. Demiraj, *art. cit.*, BUSHT, S ShSh. 1, 1959, f. 73.

14) N. Jokl, *Naim Frashëri e pasurimi i gjuhës shqipe*, në botimin përkujtimor «Naim Frashërit»; Vjershëtorit dhe edukatorit kombëtar» Graz, (Austria) 1925, f. 84-97.

gjuhëtarit, por edhe i çdo lexuesi sheh se aty qëllimi i lartë i pastrimit dhe pasurimit të gjuhës shqipe, është mbërritur duke u mbështetur fort në gjuhën e popullit, në mjetet fjalëformuese ekzistuese, në mundësitë e polisemisë dhe të përbërjes së fjalëve.

Mbi këtë bazë të shëndoshë Naimi ka krijuar një sasi shumë të madhe fjalësh të reja, nga të cilat një pjesë e mirë kanë hyrë në fondin aktiv të fjalorit të gjuhës shqipe. Po para se të japim fjalët kryesore të prejardhura edhe të përbëra të formuara nga Naimi, e quajmë me vend të themi diçka rreth atyre fjalëve të reja. Duke lexuar veprat e Naimit, sidomos shkrimet në prozë, lexuesi i sotëm vëren se shumë fjalë e terma të huaja, madje edhe të një karakteri ndërkombëtar si: *azot, astronomi, anatomi, gjeografi, gjeometri, matematikë, zoologji* etj., të cilat ne sot i përdorim vazhdimisht, aty gjenden në formën e kalkeve dmth. të përkthyer: *parrojtje, qiellshkronja, njeritregonjë, dheshkronja, dhemasja, numurëtorja, kafshëshkronja* etj. Shembuj të tillë tregojnë se rilindasit tanë, në mes të cilëve u shquan vëllezërit frashëriotë, Naimi dhe Samiu, duke shkruar libra e abetare për mësonjëtorët e para, çka ishte një nga nevojat më të ngutshme të kombit, ëndërronin edhe për një «gjithëmësim» (universitet) e shestonin plane të mëdha për përhapjen e diturisë në Shqipëri. Të vetëdijshëm se në gjuhën shqipe kishin hyrë mjaft fjalë të huaja, ata mendonin se duhej bërë një pastrim rrënjësor i saj. Kjo gjë, sipas tyre, do të mbërrihej, në radhë të parë, duke u bërë një pritë të fortë fjalëve e termave të huaja të tjera, punë e cila do të bëhej herë me kal-kime, herë me zgjerimin e kuptimeve të fjalëve ekzistuese, herë me formime fjalësh të prejardhura e të përbëra.

I nisur nga një dëshirë e tillë prej atdhetari të flaktë, Naimi kalkoi e krijoi shumë fjalë të reja, duke u mbështetur në brumin e shqipes, me qëllim që të zëvendësonte fjalët e termat e huaja. Kështu p.sh. *ushtresë* në vend të *kazermë, kapanon, kishlla*; *shëronjës*, në vend të *mjek, doktor*; *remb*, në vend të arterje, «*gjaku me anët të rembavet vjen në zemërë*» (D. 79); *fortesë*, në vend të *kala, kështjellë*; *gah*, në vend të *itinerar*, «*tjatrë gah kërkon të zerë, andaj rreh të na gënjejë*» (HS. 12); të *grime*, në vend të *sekonda*; të *holla*, në vend të *minuta*; *pasës* në vend të *satelit* «*dheu ka një pasës q'është hëna*» (D. 112); *mal që nxjerr zjarr* në vend të *vullkan*; *lemsh i dheut* në vend *glob*; *shkallë* në vend të *gradë*; *përnjeshmës* në vend të *diametër* «*përnjeshmësi është një vijë, që ndan lëshin e dheut në mest më dysh...*» (D. 85); *gjymse* në vend të *hemisferë* «*... njera thuhetë gjyms'e veriut, tjetëra gjyms'e jugësë*». (D. 85), *mollët'e dheut*, në vend të *patatet* (besojmë si kalkim nga frëngjishtja *pomme de terre*); *shtjesët* në vend të *magjistaret, orakujt*; *vjershetor* në vend të *poet*; *falëtore* në vend të *tempull*; *copë* në vend të *kapitull*, «*Iliadha si dhe Odhisja ndahetë në njëzet'e katër copë*» (Il. 9); *masë* në vend të *metër* «*këto vjersha kanë vetëm masë*» (Il. 9); *rrjeshtë* në vend të *rimë* «*... po rrjeshtë nukë kanë se qëmoti s'dihej fare rrjeshta*» (Il. 9), të *pastruara* në vend të *abstrakte* etj.

Fjalët e prejardhura

Në veprat e Naimit gjenden mjaft fjalë të prejardhura, të formuara duke u shtuar rrënjëve emërore, mbiemërore, foljore a ndajfoljore, parashtesa dhe prapashtesa të ndryshme. Neve na duket më e vlefshme që fjalët e prejardhura që kemi vjelë në veprat e Naimit t'i parashtrijmë këtu sipas kategorive gramatikore të fjalëve të formuara.

1. Emra të prejardhur:

a) me parashtesa

mosdija (M. 43), *moskamja* (P. 12), *mosqenja* (M. 63) të formuar duke vënë para emrave foljorë *dija*, *kamja*, *qënja*, parashtesën *mos*. Emrat e formuar me këtë parashtesë, siç shihet, në veprat e Naimit janë të paktë. Gjithashtu të paktë kanë qenë edhe në veprat e Samiut ku gjendet vetëm *mosdashuri*¹⁴. Megjithëse ky tip emrash nuk janë të formuar në përshtatje me natyrën e shqipes, më pas ka çarë rrugë në gjuhën tonë, siç na dëshmojnë fjalë shumë të përdorshme si *mosbesim*, *mosmarrëveshje*, *moskokëçarje* etj.

nënëmbret (IP. 98) dhe *nënëmbretëri* (IP. 108) të formuar duke u paravënë parashtesën *nënë* emrave *mbret* dhe *mbretëri*. Fjalën *nënëmbretëri* e ka përdorur edhe Samiu.¹⁵

padija (HS. 6), *paditje* (M. 71), *pa-vdekjenë* (M. 65, 67) të formuar duke u paravënë parashtesën *pa-* emrave foljorë *dija*, *ditje*, *vdekje*. Duhet të shënojmë se fjalët *padija* dhe *paditje* Naimi ashtu si edhe Samiu, i ka përdorur si dublete. Tek Samiu, përveç këtyre gjendet edhe trajta *pa-dituri*¹⁶. Fjalën *pavdekëje* e gjejmë para Naimit tek Kristoforidhi «duhetë të veshnjë pavdekëjenë»¹⁷.

parëthënje (D. 3) formuar nga *parë* + *thënje*,

përmiqyr (IP. 50) me kuptimin mbikqyrës, formuar nga *përmbi* + *qyr*;

b. me prapashtesa

hindas (Il. 3), *kinas* (Il. 3), *thivasit* (P. 5) të formuar nga emrat Hind, Kinë, Thivë (= Tebë) me prapashtesën *-as*.

lëkurçe (D. 45), formuar nga *lëkurë* + *çe*. (= krahët e lakuriqit të natës) «Në mest të shpeset të kësaj fare është lakuriqësi, që fluturon me ca lëkurçe që ka si krahë...»

Një sasi e madhe emrash dalin të formuar me prapashtesën *-ës*, e cila në shumicën e rasteve u është shtuar temave foljore të kohës së tashme (veta e parë): *mbanjës* < *mbanj*, *mundonjës* < *mundonj*, *shkretonjës* < *shkretonj*, *shëronjës* < *shëronj*, *rrotullonjës* < *rrotullonj*, *rrëmbenjës* < *rrëmbenj*, *rrëfenjës* < *rrëfenj*, *mburonjës* < *mburonj*,¹⁸ *peshonjës* < *peshonj*. Po ka edhe një numër emrash me prapashtesën *-ës* të cilët janë formuar edhe nga tema e pjesores së foljeve përkatëse: *shpenës* < *shpenë*, *dhënës* < *dhenë*, *ruajtës* < *ruajtur*, *shitës* < *shitur*, *blerës* < *blerë* etj.

Prapashtesën *-ës*, Naimi e ka përdorur jo vetëm me tema foljore, siç u pa më lart, por edhe me tema emërore. Kështu psh., ai ka krijuar emrin *qint-dorësin* (Il. 37). Këtë rrugë të formimit të emrave e gjejmë edhe tek i vëllai Samiu, i cili ka *katër-dorës*, *katërkembës*, *mesditës* etj.¹⁹

Shumë emra ka formuar Naimi edhe me prapashtesën (ë)ri e cila u është shtuar temave emërore të numrit njëjës, qofshin mashkullorë qofshin femërorë, ndërsa emri i formuar është i gjinisë femërore: *armi-*

14) Sh. Demiraj, *Gjuha e Sami Frashërit*, BUSHT, SShSh, 3, 1957, f. 192.

15) Po ai, po aty.

16) Demiraj, *art. cit.*, f. 194.

17) Kol Ashta, *Neologjizmat në shkrimet e Kostandin Kristoforidhit*, dorëshkrim në arkivin e Institutit të historisë dhe të gjuhësisë.

18) Më përpara Kristoforidhi ka përdorur *mburonjës* me kuptimin *difensore* (Kol Ashta, *art. cit.*)

19) Sh. Demiraj, *art. cit.*, f. 20.

këri < *armik* (HS. 108); *ligjëri* < *ligj* (HS. 30), *makutëri* < *makut* (HS. 177, DB. 15), *qytetëri* < *qytet* (HS. 6), *shtrigëri* < *shtrigë* (HS. 178), *foshnjëri* < *foshnjë* (M. 35), *kafshëri* < *kafshë* (M. 59), *Shqiptarëri* < < *shqiptar* (M. 61), *myslimanëri* < *mysliman* (Il. 11), *protestanëri* < < *protestan* (Il. 78), *shokëri* < *shok* (Il. 5).

Duhet shënuar se disa nga këta emra të prejardhur gjenden edhe në veprat e Samiut e të ndonjë rilindasi tjetër. Kështu psh. tek Samiu gjenden: *armikëri*, *myslimanëri*, *qytetëri*, *shqiptarëri*²⁰.

Me prapashtesën -(ë)si në veprat e Naimit ka një sasi emrash, të cilët janë formuar nga tema mbiemërore si: *butësi* < *i butë* (HS. 173), *fatbardhësi* < *fatbardhë* (M. 41), HS. 172) *shpirtmadhësi* < *shpirtmadh* (HS. 172), *prapësi* < *i prapë* (M. 31) *poshtësi* < *i poshtë* (M. 73), *drejtësi* < *idrejtë* (Il. 6), *ngrohtësi* < *i ngrohtë* (M. 3), *urtësi* < *i urtë* (M. 29) etj. Ndonjë nga këto fjalë është përdorur edhe nga rilindasit e tjerë; kështu psh. Samiu ka *urtësi*, *mirësi* etj.

Me prapashtesën -esë tek Naimi gjenden²¹ emrat: *fortesë* (HS. 139) formuar nga mbiemri *i fortë*, jo pa ndikim nga fr. *forteresse* = kala, kështjellë; *shtresë* (BB. 19) nga *shtroj*, *ushtresë* (HS. 156) nga *ushtroj*, *shërbesë* (M. 47) nga *sherbej*.

Disa emra në veprat e Naimit janë formuar edhe me prapashtesën -i nga tema mbiemërore: *dobëti* < *i dobët* (HS 4, IP. 57), *mituri* < *i mitur* (P. 69) po edhe nga tema emërore: *dhelperi* < *dhelper* (HS. 5), *mjeshtëri* < *mjeshtër* (P. 56), *kusëri* < *kusar* (HS. 41), *njerëzi* < *njerëz* (Il. 5), *robëri* < *robër* (P. 71) etj.

Prapashtesa -im, në veprat e Naimit nuk del aq prodhimtare sa ç'është bërë sot, po disa emra të formuar me të janë: *kallëzim* (HS. 177, M. 36), *lakëmime* (HS. 177, M. 40), *ligjërim* (BB. 19), *rënkim* (HS. 19), *mërgim* (M. 31), *shpërnderim* (M. 36), *gjellim* (M. 40), *peshim* (M. 49), *mallëngjim* (P. 59), *veshtim* (P. 9), *paqësim* (Fl. B. 11), *këndim* (tek «E këndimit...»), *mësim* (tek «Mësimë») etj. Fjalët *këndim* dhe *mësim* i ka përdorur edhe Samiu. Prapashtesën -je Naimi e ka përdorur për të formuar emra prej temash foljore herë të mënyrës dëftore, herë të pjesores): *ndesje* (HS. 177), *ngrënje* (BB. 23, M. 43), *presje* (HS. 177), *kamje* (M. 38), *dhenjen'e marrjenë* (M. 44), *parje* (M. 71), *berje qiejvet* (M. 78), *zihje* (Il. 5), *kthyerje* (D. 11), *pirjen'e verësë* (Il. 23), *ditje* (Il. 50). Ndonjë nga këto fjalë si *ditje*, *presje*, është përdorur edhe nga Samiu.

Me prapashtesën -ore tek Naimi gjenden emrat *fletore* (M. 31), *pe-shore* (IP. 115).

Me prapashtesën -sirë dalin emrat *hapësirë* (BB. 20), besojmë nga mbiemri *i hapët* ose nga pjesorja e foljes *hap*, *prapësirë* (HS. 41) nga mbiemri *i prapë*, dhe *ftohtësirë* (LV. 5) nga mbiemri *i ftohtë*.

Një numër emrash janë formuar edhe me prapashtesën -tar: *ushtëtar* (HS. 35) nga *ushtë*, *memëdhetar* (M. 56), *dëshmitar* (M. 69) *besëtar* (Il. 38) *shigjetëtar* (Il. 9). Pas Naimit, fjalën *memëdhetar* e ka përdorur edhe Samiu, me të njëjtin kuptim si ai. Me prapashtesën -tor tek Naimi gjenden emrat: *gjahëtor* (BB. 9), *vjershëtor* (Il. 3), *paqëtor* (D. 88), *anijetuar* (KÇ. 27). Me prapashtesën -tore janë formuar emrat: *falëtore* (Il. 7), *numera-tore* (Il. 114), *këndonjëto* (KÇ. 4), *hietore* (KÇ. 18), *mësonjëto* etj.

c. me *parashtesa* dhe *prapashtesa* të shtuara në të njëjtën kohë

20) Po ai, f. 203, f. 206, f. 207.

21) Sh. Demiraj, *art. cit.*, f. 209,

22) Sh. Demiraj, *art. i cit.*, f. 194,

(= fjalëformim prefikso-sufiksial = *pabesi* (HS. 178). Kjo është trajta më e shpeshë, po në disa raste Naimi ka përdorur me të njëjtin kuptim edhe trajtën *pabesëri* (M. 53), e cila gjithashtu është e formuar sipas tipit prefikso-sufiksial. Trajtën *pabesëri* e ka përdorur edhe Samiu²². Në gjuhën e sotme ka hyrë trajta e parë, *pabesi*, *pa-punësija* (M. 46), *panginjësinë* (M. 81), *pa-udhësija* (LV. 11).

2. Mbiemra të prejardhur

a. me parashtesa:

Shumica e mbiemrave të formuar me parashtesa përbëhet nga ato që kanë parashtesën *pa-*, e cila zakonisht u është shtuar po mbiemrave: *i pa-arësyer* (M. 35), *i pa-çmuar* (LV. 55, D. 24), *i padëgjuarë* (IP. 56), *i pa-dukurë* (D. 129), (këtë fjalë e ka përdorur më përpara Kristoforidhi²³), të *pa-fëlliqurë* (M. 33), *i pagdhendurë* (M. 63), të *pagoditurë* (D. 16), të *pa-helmuarë* (P. 76), të *pa-lyer* (HS. 209), të *pambarë* (HS. 40), të *pa-mbaruara* (D. 16), *i pa-mësuar* (P. 54), të *pa-mihura* (D. 100), të *pa-ndaluarë* (M. 66), të *pa-ndarë* (P. 59), *i pa-ndyrë* (M. 30), (edhe këtë fjalë e gjejmë më parë tek Kristoforidhi me trajtën e *pandyme*²⁴, e *pa-nemurë* (IP. 3), e *pa-ngjarë* (HS. 13), *i pa-njohurë* (D. 105), *i pa-pëlqyer* (HS. 40), e *pa-përmen-durë* (IP. 83), *i pa-përzjerë* (HS. 31), e *pa-prerë* (IP. 75), të *pa-qeshur* (HS. 30), *i pa-qëruarë* (D. 80), e *pa-sosurë* (M. 51), të *pa-shtrohur* (HS. 56), e *pa-shuar* (HS. 170), *i pa-tundur* (HS. 141), të *pa-zhezhiturë* (D. 81).

Një pjesë e vogël e mbiemrave të prejardhur me parashtesën *pa-* janë formuar jo nga mbiemrat po nga emrat. Të tillë janë: *i pa-anë* (M. 30), e *pa-fletë* (D. 26), *i pa-shpresë* (BB. 21), *i pa-vdekë* (M. 48).

b. me prapashtesa:

Me prapashtesën *-arak* në veprat e Naimit gjenden mbiemrat: *fusharak*, *hindorak*, *sisarak*, *vraparak*, *vezarak* të formuar prak. nga emrat: *fushë*, *Hind*, *sisë*, *vrap*, *vezë*. Gjendet gjithashtu mbiemri *vjedharak* i formuar nga rrënja foljore *vjedh*. Një numër i kufizuar mbiemrash paraqiten te formuar me prapashtesën *-m(ë)* mbi bazën e rrënjëve emërore si: *te sheshmitë* (D. 7) nga *shesh*, po edhe nga ndajfoljet si *e veçme* (IP. 7), të *pasmit* (IP. 20). Me prapashtesën *-njtë* në veprat e Naimit gjendet vetëm një mbiemër: *e borinjtë* (LV. 62).

Me prapashtesën *-ore* dalin: *gjelbërore*, *pëllore*. Me prapashtesën *-osh(e)*: *përkëdheloshe* nga tema e foljes *përkëdhel*, sipas modelit popullor *bukuroshe*, *vogëloshe*, të cilat i gjejmë edhe në veprat e Naimit. Me prapashtesën *-shmë-e*, e cila ndonjëherë del edhe me trajtën *çim-e*, tek Naimi gjenden: *i perendishmë* (HS. 87, Il. 49), e *perzishmezë* (BB. 20), *trupat e qiejshme* (M. 33), *t'uujshme* (Il. 32), e *nderçime* (D. 125), *ver e gjithnjeshme* (P. 13), *koh shumë e bëshme* (P. 13).

Me prapashtesën *-(j)të* janë formuar mbiemrat: të *ergjenttë* (BB. 14),

23) Kol Ashta, art. cit.

24) По аи, по аты.

të florinjta (BB. 14), i kërthijtë (BB. 19), të perëndijta (BB. 19), i tymtë (D. 128), të ngurëtë (D. 128), të kockëta (D. 62), të barta (D. 31), i gjaktë (II. 57).

Me prapashtesën *-ush(ë)* në veprat e Naimit ka pak mbiemra; kemi gjetur vetëm: *bardhush* (HS. 120), *sylarushë* (HS. 103, 171).

c) me parashtesa dhe prapashtesa të shtuara njëkohësisht një teme emërore ose foljore: *perdhese* (BB. 18), *e përgjithëshme* (IP. 3), *i përjetshëm* (M. 48), *e përzishme* (BB. 20).

3. Folje të prejardhura

a. me parashtesa:

Me parashtesën *çpër-* e cila në veprat e Naimit del ndonjëherë edhe me trajtën *shpër-* janë formuar foljet *çpërblehetë* (IP. 114), *çpërlahetë* (IP. 114), *shpërnderoj* (HS. 4, II. 28). Tek Samiu gjendet trajta të *çpërnderë*,²⁵ me kuptimin *çnderoj*, *turpëroj*, po as njëra as tjetra nuk kanë hyrë dot në përdorim. Me parashtesën *për-* tek Naimi gjenden foljet: *përgëzoj* (BB. 9), *përkujdes* (M. 30), *përkëthehetë* (M. 39), *përlëfytem* (HS. 143), *përmbledh* (HS. 127, II. 20), *përmbush* (BB. 17), *përpiqet* (me kuptimin takohet, piqet) (M. 76), *përshtëndosh* (HS. 78).

b. me prapashtesa:

Me prapashtesën *-oj(onj)* Naimi, sipas modelit popullor ka krijuar një numër foljesh si: *dobëtoj* (HS. 13), *madhoj* (HS. 44), *ndrejtoj* (HS. 166), *qetoj* (HS. 28), *ashpëroj* (IP. 86) nga mbiemrat përkatës: *i dobët*, *i madh*, *i ndrejtë*, *i qetë*, *i ashpër*. Po me prapashtesën *-oj* tek Naimi gjenden edhe folje të formuara nga emrat: *qafoj* (HS. 85), *dëmon* (M. 55), të formuara nga *qafë* dhe *dëm*.

Me prapashtesën *-os* tek Naimi gjenden foljet: *radhos* (HS. 141), *guros* (D. 12), *mermeros* (D. 12).

Me prapashtesën *-sonj* Naimi ka formuar folje nga mbiemrat dhe ndajfoljet: *lartësonj* (HS. 84, IP. 5), *largësonj* (HS. 20); *madhësoj* (HS. 60), *poshtëronj* (M. 31), *pakësohetë* (M. 39), *fatbardhëson* (LV. 20), *fortëson* (IP. 64).

4. Ndajfolje të prejardhura.

Në veprat e Naimit gjenden edhe disa ndajfolje të formuara me prapashtesën *-azi*: *flashkazi* (D. 114), *gjatazi* (D. 94), *fshehtazi* (HS. 38), *kokëngjylmazi* (D. 114), *lehtazi* (HS. 58), *qetazi* (HS. 58).

Me prapashtesën *-za* në veprat e Naimit gjendet vetëm një ndajfolje: *faqeza* (M. 31, II. 35).

25) Sh. Demiraj, *art. i cit.*, f. 192.

Fjalët e përbëra

Në veprat e Naimit gjenden një sasi e madhe fjalësh të përbëra, të cilat edhe pse në mjaft raste nuk kanë zënë vend në gjuhë, kanë një vlerë të madhe, për arsye se ato, duke qenë formuar mbi baza të drejta e sipas modeleve ekzistuese të gjuhës shqipe, tregonin se edhe shqipja kishte mundësi dhe mjete të mëdha shprehëse, të pashfrytëzuara, mbi bazën e të cilave do të merrete formën e një gjuhe të shkruar letrare.

Shumica e fjalëve të përbëra që gjenden në veprat e Naimit janë mbiemra, po ka edhe disa emra, folje e ndajfolje. Le t'i vështrojmë si paraqiten për nga ana e formimit.

1. Mbiemra të përbërë.

a. nga një emër + një mbiemër cilësor: *burra-madhe* (Il. 22), *ditë-zi* (HS. 49), *dorë-gjati* (HS. 46), *duar-thatë* (Il. 21), *dhembje-math* (M. 29, 36), *faqe-zjartë* (HS. 42), *fjalë-bukur* (Il. 16), *fjalë-ëmbëlë* (HS. 86), *gjëmë-madhi* (HS. 208), *hark-bukur* (Il. 40), *jetë-gjatë* (HS. 182, P. 39), *jetë-shkurtër* (Il. 34), *këmbë-bukur* (Il. 45), *këmbë-çpejtë* (Il. 11), *këmbë-qetë* (HS. 260), *këmishë-zi* (HS. 98), *kërsinj-thatë* (HS. 51), *kokë-trashë* (P. 75), *kokë-thatë* (P. 74), *krahor-gjëri* (HS. 148), *krye-gjatë* (D. 64), *lakëmim-madhi* (M. 40), *lesh-bardhë* (HS. 16), *lesh-bukur* (Il. 15), *leshra-gjatë* (HS. 148), *lugë-thatë* (HS. 192), *llerë-bardhë* (Il. 16), *mendje-gjerë* (HS. 16), *mendje-lirë* (HS. 240), *mendje-ndritur* (HS. 25), *mendje-shkurtë* (HS. 25), *mjekrë-gjatë* (HS. 51), *mjekrë-verdhë* (HS. 241), *mjekrë-zi* (HS. 137), *mustaqe-zi* (HS. 213), *ndjesë-madh* (M. 65), *punë-mbarë* (HS. 252, P. 45), *pulpë-mirë* (Il. 14), *qafë-gjatë* (HS. 103), *sisë-bardhë* (P. 10), *shpatulla-gjerë* (HS. 137), *shpirt-errëtë* (HS. 21), *shpirt-madhi* (P. 45), *shpirt-zi* (M. 40), *shtat-mirë* (HS. 42), *trimëri-math* (M. 49), *zë-bukur* (HS. 86), *zembrë-gjerë* (LV. 12), *zembrë-madhi* (HS. 80), *zembrë-ligë* (LV. 17), *zembrë-zestë* (M. 80), *zë-kthiellta* (Il. 49), *vesh-gjatë* (P. 47), *vrap-mëdhenj* (P. 11), *vetull-zi* (IP. 45).

b. nga një emër + një emër foljor: *bar-ngrënëse* (D. 17, 18) *dishmim-dhënës* (Il. 33), *dritë-dhënës* (Il. 17, M. 51, 77), *njerëzi-hamës* (Il. 27), *rrufe-hedhës* (Il. 48), *rrufe-shtënës* (Il. 49), *trima-vrasës* (Il. 27).

c. nga një emër + një emër (kompozita përcaktuese): *dorë-hekurt* (Il. 57), *fytyrë-henë* (BB. 20), *hark-ergjentë* (Il. 15), *këmbë-bukuroshe* (Il. 46), *këmbë-djallë* (HS. 49), *këmbë-ergjentë* (P. 10), *këmbë-kuc* (HS. 142), *kokë-rojelle* (HS. 30, 33), *krahor-ergjentë* (HS. 141), *lesh-florinjte* (P. 10), *leshra-krende* (LV. 18), *sy-larushë* (HS. 103, 171), *sy-lugat* (HS. 48), *sy-mëshqerë* (Il. 46, LV. 56), *sy-shkëndije* (HS. 97), *zemre-det* (HS. 112), *zemre-hekur* (HS. 250, M. 40), *zemre-killirë* (HS. 21), *zemre-brumbull* (HS. 30).

ç nga një emër + një ndajfolje: *brigje-shumë* (Il. 43), *darovë-shumë* (IP. 28), *durim-shumë* (M. 49), *fuqi-shumë* (M. 66), *gjumë-shumë* (HS. 193), *kërcëllimë-shumë* (M. 74), *kursim-shumë* (M. 40), *lule-shumë* (P. 10), *mendje-paku* (P. 67), *mendje-shumë* (HS. 292), *mëshirë-shumë* (M. 65), *shkëmbenj-shumë* (D. 106), *tëmerr-shumë* (Il. 25), *valë-shumë* (HS. 76).

d. nga një emër + një pjesore: *buzë-lëshuar* (HS. 30, 33, 149), *buzë-pjekur* (HS. 76), *buzë-plasur* (BB7), *dorë-hapët* (M. 40), *fytyrë-qarë* (HS. 35), *gjak-ngrirë* (P. 62), *gishtrinj-ngjyer* (Il. 42), *këmbë-zbathurë* (M. 42, HS. 51), *kok'unjur* (LV. 32), *kordhë-larë* (HS. 137), *kordhë-xhveshur* (HS. 43), *krahë-shkruar* (BB. 9), *krye-kthyer* (Il. 23), *llerë-përveshur* (HS. 19), *zemrë-djegur* (HS. 29),

2. Emra të përbërë

a. nga një emër + një emër tjetër (me lidhje këpujore, përcaktore ose pronësore): *besa-besë* (=unitet, besëlidhje) (P. 29, HS. 5), *dritë-shkronjë* (IP. 115) *dhe-shkronjë* (D. 83), *dhe-tregonja* (IP. 4), *erë-peshonjësi* (D. 131), *endërrë-rrëfenjës* (Il. 17), *ergjent-punonjës* (P. 60), *fe-zija* (HS. 45), *fjalë-venës* (Il. 28), *fjamur-mbanjës* (HS. 187), *jetë-shkronjë* (IP. 7), *jugë-lindje* (IP. 8), *kartë-shpenës* (HS. 55), *kafshë-shkronjë* (IP. 114), *krye-qytet* (IP. 17, 36), *lopata-heqës* (Il. 21), *meme-dheu* (M. 53), *mësim-dhënës* (HS. 23), *mes-ditës* (D. 85), *njeri-tregonja* (IP. 4, D. 57), *qiell-shkronja* (D. 111, IP. 16), *shigjetë-hedhës* (Il. 7), *shpirt-madhësija* (HS. 174), *shtyp-shkronjë* (IP. 174), *udhë-rrëfenjës* (IP. 5, M. 58), *venë-shitës* (M. 36).

b. nga një numëror + një emër: *gjymsë-dele* (D. 17), *gjymsë-kalë* (D. 17), *gjymsë-njeri* (IP. 29), *gjymsë-perendi* (Il. 6), *qint-dorës* (Il. 37),

c. Nga një përemër + një emër: *vetë-dija* (HS. 172, M. 29).

3. Folje dhe ndajfolje të përbëra, në veprat e Naimit ka pak. Kemi gjetur foljen *fat-bardhësoj* (P. 14) e cila paraqitet si një fjalë e prejardhur mbi bazën e një fjale të përbërë, pra nga mbiemri i përbërë *fat-bardhë* + prapashtesën *-soj*. Nga ndajfoljet e përbëra gjendet *kokë-ngjylmazi* (D. 7), formuar me kompozim dhe sufiksime të njëkohëshëm sipas tipit popullor *këmba-doras*.

Nga ajo sasi e madhe fjalësh të prejardhura dhe të përbëra që gjenden në veprat e Naimit, vetëm një pjesë e vogël kanë hyrë në fondin aktiv të fjalorit të shqipes, mirëpo kjo nuk ia bjerr aspak vlerën dhe kontributin atij lavruesi të shquar.

Përkundrazi, ato mbeten si një dëshmi e përpjekjeve të tij për pasurimin dhe pastërtinë e gjuhës shqipe dhe si një shembull i shkëlqyer i dashurisë dhe kujdesit të poetit për gjuhën shqipe, të cilës ai i thuri vargjet më të bukura:

«Gjuha jonë sa e mirë!
Sa e embël! sa e gjerë!
Sa e lehtë! sa e lirë!
Sa e bukur! sa e vlerë!»

Përfundime

Kujtojmë se me këto shënime del se Naim Frashëri bashkë me të vëllanë, Samiun, në lëvrimin e gjuhës shqipe ndoqi udhën që kishte zënë N. Veqilharxhi e që e kishte shtruar e përvijuar Kostandin Kristoforidhi. Mund të thuhet plot gojën se në sajë të punës së kujdeshme që bënë këta pinjoj të shquar të Rilindjes sonë kombëtare, gjuha shqipe letrare, jo vetëm zuri rrënjë të shëndosha por edhe u rrit e u pasurua, pësoi ndryshime të dukshme, sidomos në fushën e fjalorit. Është meritë e Naimit që mbi bazën e ligjeve dhe të brumit të shqipes krijoi një sasi të madhe fjalësh të reja, të cilat i përdori për të shprehur kuptimet e reja, dituritë dhe mësimet si dhe «fjalët e gjuhës së zjarhtë».

Tashmë është e ditur se në shekullin e kaluar, sidomos në 30 vjetet e fundit të tij, qe krijuar një rrymë e fuqishme përparimtare e cila duke dalë me parullën e spastrimit të gjuhës shqipe nga huazimet e panevojshme, bëri me vete shumë shkrimtarë, të cilët veprat e tyre u përpoqën

1) Në Dangëlli (Frashër) përdoret: gjysmë dhe jo: gjymsë!

t'i shkruanin me një gjuhë sa më të pastër, sa më të qartë po edhe sa më të pasur. Në krye të kësaj rryme, si dy pishtarë të mëdhenj, gjithnjë të pashuar qëndronin vëllezrit frashëriotë, vazhduesit me të zellshëm të punës së K. Kristoforidhit.

Gjuha e Naimit, sikundër doli edhe nga shënimet e këtushme, ka për bazë nëndialektin e Dangëllisë, po kjo nuk do të thotë aspak se gjuha e veprave të tij mbetet jashtë sferës së gjuhës letrare. Përkundrazi, megjithë ndikimet e nëndialektit, me gjithë lëkundjet dhe shmangjet që përmendëm në këtë artikull, gjuha e Naimit është prapëseprapë një toskërishte e punuar, e kuptueshme jo vetëm nga toskët po edhe nga gegët. Gjuha e veprave të Naimit u vështrua si shembull, si model nga shkrimtarët e tjerë jugorë të mëpastajmë gjë që solli si pasojë formimin e një toskërishteje letrare e cila përbën bazën e shqipes letrare të sotme.

Po kur themi se Naimi me lëvrimin e gjuhës shqipe kontribuoi në themelimin e gjuhës letrare shqipe nuk duhet kuptuar aspak sikur vepra e tij ishte tërësisht «gjuhë letrare». Formimi i gjuhës letrare shqipe është frut i punës dhe përpjekjeve të një vargu shkrimtarësh, të cilët duke ndjekur shembullin e Naimit, ecën gjithnjë e më përpara drejt krijimit të një shqipeje letrare me drejtshkrim të njësuar, me trajta morfologjike sa më të përgjithshme, me një frazë të përpunuar e elegante dhe me një fjalor sa më të pasur e të spastruar nga barbarizmat.

R é s u m é

A PROPOS DE LA LANGUE DE NAIM FRASHËRI

L'oeuvre de Naim Frashëri est devenue depuis longtemps l'objet d'études non seulement de la part des critiques littéraires et des historiens de la littérature, qui sont attirés par les grandes idées patriotiques, traduites au moyen de figures artistiques réussies, mais aussi de la part des linguistes, qui ont trouvé en elle des manifestations nombreuses qui parlent des efforts du poète à enrichir le vocabulaire de la langue albanaise, à établir une orthographe commune, etc.

Dans cet article aussi est donné un aperçu général sur la langue de Naim Frashëri, s'arrêtant en particulier sur la contribution qu'il a donné dans le domaine de l'orthographe, des formes morphologiques et dans le dictionnaire.